

VENDIM
Nr. 104, datë 31.5.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “FAETHON” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/1 prot., datë 29.5.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘FAETHON’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.5.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, vërehet se kërkesa për licencim, formati i aplikimit dhe shtojcat 1 A dhe 2 mbajnë vetëm një nënshkrim administratori, pa shënuar emrin e tij. Kërkesa për aplikim duhet të nënshkruhet nga administratori që përmban tagrat e përfaqësimit ligjor, duke cilësuar edhe emrin dhe mbiemrin e tij.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Po ashtu nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “c”; për pikën 2.1, gjerat: “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 5.4.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 93 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, nga shoqëria ‘FAETHON’ sh.p.k.”; po ashtu, shoqëria është pajisur me deklaratën Mjedisore, lëshuar më 4.10.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN310820230006, për të zhvilluar projektin për ndërtimin e parkut fotovoltaike në Libohovë; si dhe është pajisur nga shoqëria OST sh.a. me miratimin në parim për lidhjen e parkut fotovoltaike Libohovë me rrjetin e transmetimit, nëpërmjet shkresës nr. 2041/1 prot., datë 20.4.2023.

- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni, si vijon:

Neni 9, Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë dëshminë e penalitetit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për shoqërinë “FAETHON” sh.p.k. dhe për të tre administratorët e saj;

- germa “c”: aplikuesi duhet të depozitojë strukturën organizative në format origjinal, ose fotokopje të njëzuar me origjinalin;

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a”: aplikuesi duhet të depozitojë dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare, referuar vlerës së investimit në kontratën me MIE-n;

- germa “c”: aplikuesi duhet të depozitojë miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit, si dhe informacionin/sqarimet përkatëse, përse kërkesa e lidhjes është bërë me kapacitetin e instaluar 93 mwp, ndërkohë që në kontratën e nënshkruar me MIE-n dhe në deklaratën mjedisore ky kapacitet është 93 mw.

- Në kuadër të vlefshmërisë së deklaratës mjedisore (deri më 4.10.2025) dhe duke qenë se në shtojcën e të dhënave teknike shoqëria ka bërë me dije se punimet e centralit parashikohet të bëhen gjatë vitit 2024, ajo duhet të informojë/dokumentojë fillimin e punimeve.

- Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacion, në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “FAETHON” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti